



ANALIZË E NEVOJAVE TË SHKOLLAVE PARTNERE PËR KLUBE TË KARRIERËS

Publikuar nga:

Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit
(GIZ) GmbH

Autor:

Elmedina Nikoceviq - Kurti, MDA

Koordinuar nga:

Nexhmedin Basha, GIZ Kosova

Janar 2024, Prishtinë

Ky publikim është hartuar nga MDA me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Opinionet e shprehura janë të autorit (ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e GIZ-it ose të Qeverisë Gjermane.

Përmbajtja

Informata të përgjithshme	3
Shkollat partnere	4
Instrumenti	4
Rezultatet e vlerësimit të nevojave të shkollave për Klubet e karrierës	6
Shkollat pjesëmarrëse.....	6
Format e ofritit të edukimit dhe orientimit për karrierë në shkollat partnere.....	7
Statusi dhe nevojat e Klubeve të karrierës në shkollat pjesëmarrëse.....	11
1. ShFMU “Nazim Gafurri”, Prishtinë.....	11
2. ShFMU “Ibrahim Fehmiu”, Prizren.....	12
3. ShFMU “Pjetër Bogdani”, Prishtinë.....	13
4. ShFMU “Thimi Mitko”, Gjilan.....	14
5. ShFMU “Liria”, Vushtrri.....	15
6. ShFMU “Rexhep Kadrija”, Deçan	16
7. ShFMU “Ramë Bllaca”, Suharekë.....	17
8. ShFMU “ Xhemail Mustafa”, Prishtinë.....	18
9. ShFMU “Asim Vokshi”, Prishtinë	19
10. ShFMU “Bedri Gjinaj”, Mitrovicë.....	20
11. ShFMU “Shaban Jashari”, Skenderaj.....	21
12. ShFMU “Selman Riza”, Gjakovë	22
13. ShFMU “Zija Shemsiu”, Gjilan.....	23
14. ShFMU “Anton Zako Çajupi”, Mitrovicë.....	24
15. ShFMU “Emin Duraku”, Prishtinë	25
16. ShFMU “Neze Bujani”, Lipjan.....	26
17. ShMU “Emin Duraku”, Shtime.....	26
18. ShFMU “Tefik Çanga”, Ferizaj.....	27
19. ShFMU “Ismail Qemali”, Ferizaj.....	28
20. ShFMU “Naim Frashëri”, Drenas	29
Tregu i punës dhe aftësitë e kërkuara.....	30
Nevoja për mbështetje nga projekti për funksionimin e Klubeve të karrierës.....	32
Përfundime dhe rekomandime.....	34
Shtojca	36

Informata të përgjithshme

Qeveria Gjermane nëpërmjet projektit “Fit for Jobs” të GIZ Kosova, synon rritjen e punësimit të të rinjve kosovarë duke përmirësuar cilësinë e orientimit drejt arsimit dhe formimit profesional, orientimit në karrierë dhe masave të tregut aktiv të punës, si shërbimet e kërkimit të punës.

Projekti operon në katër fushëveprime që përfshijnë:

- 1) Lehtësimin e kalimit nga shkollat e mesme të ulëta në arsimin profesional dhe trajnime;*
- 2) Promovimin e përfshirjes sistematike të sektorit privat në arsimin profesional dhe trajnime;*
- 3) Përfshirjen e orientimit të arsimit (profesional) në tregun e punës me politika dhe strategji të reformës;*
- 4) Përmirësimin e cilësisë së Shërbimeve të Tregut të Punës për të rinjtë (18 – 29 vjeç) në Kosovë.*

Prej majit të vitit 2020 deri në shkurt të vitit 2021, GIZ-i është përfshirë në themelimin e Klubeve të karrierës në 20 shkolla. Procesi përfshinte rekrutimin e nxënësve, ofrimin e trajnimeve, krijimin e planeve të punës dhe aktivitetet e veprimit. Koncepti u zhvillua në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit, duke u fokusuar në aftësitë e buta, ndërmarrësi, edukimin për karrierë, angazhimin me komunitetin e biznesit dhe promovimin e shërbimit ndaj komunitetit.

Së fundmi, GIZ, nëpërmjet “Fit for Jobs” ka iniciuar projektin e ri me titull “Mbështetja e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta përmes zhvillimit dhe forcimit të Klubeve të Karrierës” i financuar nga GIZ, i cili synon mbështetjen e klubeve ekzistuese të karrierës dhe themelimin e klubeve të reja në 20 shkolla të mesme të ulëta në 13 komuna.

MDA, si kontraktor i angazhuar për implementimin e projektit, në pjesën e fazës përgatitore ka realizuar analizën e nevojave të shkollave partnere për themelimin ose

fuqizimin e Klubeve të karrierës. Për më shumë, nëpërmjet pyetësorit të shpërndarë në e-maillet e 20 shkollave partnere, është kryer vlerësimi i nevojave për të identifikuar shkollat që aktualisht kanë klube të karrierës dhe nivelin e tyre të funksionalitetit, si dhe shkollat që janë të interesuara për t'i themeluar klubet e karrierës.

Shkollat partnere

Listën e shkollave partnere e përbëjnë 20 shkolla të mesme të ulëta në 13 komuna të Kosovës, si: Prishtinë, Skenderaj, Drenas, Ferizaj, Vushtrri, Mitrovicë, Lipjan, Deçan, Therandë, Shtime, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan. Drejtorët dhe koordinatorët e cilësisë janë informuar paraprakisht nëpërmjet e-mailit për fillimin e projektit, qëllimin dhe kontributin që do sjellë ky projekt për shkollën e tyre.

Instrumenti

Pyetësi është përgatitur enkas për qëllimet e këtij projekti (*shih shtojcën*). Nëpërmjet pyetësorit synohej vlerësimi i nevojave të shkollave për Klubet e karrierës dhe mbledhja e informatave për funksionalitetin e klubeve dhe mundësitë e fuqizimit të tyre. Pyetësi u është dërguar drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë të shkollës nëpërmjet e-mailit. Ky pyetësor, i përgatitur në Google form është përbërë prej 72 pyetjeve dhe përmban 4 seksione me pyetje, si:

- *seksioni 1: të dhënat demografike;*
- *seksioni 2: për shkollat që tashmë kanë Klubin e karrierës dhe është funksional;*
- *seksioni 3: për shkollat që kanë të themeluar Klubin por është momentalisht jofunksional, si dhe,*
- *seksioni 4: për shkollat që janë të interesuar të themelojnë Klubin e karrierës.*

Pyetësi përmbante pyetje të hapura dhe me opsione. Pyetjet për të dhënat demografike vlenin për të gjithë respondentët, derisa varësisht nga opsioni i përzgjedhur në pyetjen 8: “Zgjedhni opsonin që u përshtatet dhe vazhdoni në seksionin e

rekomanduar: a) *Shkolla jonë e ka të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional;*
b) *Shkolla jonë e ka të themeluar Klubin e karrierës por nuk është funksional* dhe c) *Shkolla jonë është e interesuar të themelojë Klubin e karrierës,* automatikisht respondentët janë bartur në seksionin me pyetjet e përshtatura opsionit të zgjedhur. Kohëzgjatja për plotësimin e pyetësorit ishte deri 10 minuta.

Rezultatet e vlerësimit të nevojave të shkollave për Klubet e karrierës

Shkollat pjesëmarrëse

Pyetësit për analizën e nevojave të shkollave partnere sa i përket funksionimit të Klubeve të karrierës u janë përgjigjur të gjitha shkollat partnere, përkatësisht 20 shkolla të mesme të ulëta në 13 komuna të Kosovës. Lista e shkollave të cilat i janë përgjigjur pyetësorit janë listuar në tabelën 1. Numri total i nxënësve prej klasës së 6-të deri në klasën e 9-të në këto shkolla varion prej 62 deri 764. Shumica e respondentëve të cilët janë i përgjigjur pyetësorit janë drejtorët e shkollave, specifikisht 12 prej tyre, 3 janë koordinatorë të cilësisë, 2 janë këshilltarë për karrierë dhe 3 mësimdhënës.

Tabela 1. Shkollat respodente

	Komuna	Emri i shkollës	Numri i nxënësve Klasa 6-9
1.	Prishtinë	ShFMU “Nazim Gafurri”	407
2.	Prizren	ShFMU “Ibrahim Fehmiu”	410
3.	Prishtinë	ShFMU “Pjetër Bogdani”	214
4.	Gjilan	ShFMU “Thimi Mitko”	657
5.	Vushtrri	ShFMU “Liria”	95
6.	Deçan	ShFMU “Rexhep Kadrija”	72
7.	Therandë	ShFMU “Ramë Bllaca”	152
8.	Prishtinë	ShFMU “Xhemail Mustafa”	470
9.	Prishtinë	ShFMU “Asim Vokshi”	218
10.	Mitrovicë	ShFMU “Bedri Gjinaj”	220
11.	Skenderaj	ShFMU “Shaban Jashari”	670
12.	Gjakovë	ShFMU “Selman Riza”	235
13.	Gjilan	ShFMU “Zija Shemsiu”	221
14.	Mitrovicë	ShFMU “Anton Zako Çajupi”	295
15.	Prishtinë	ShFMU “Emin Duraku”	280
16.	Lipjan	ShFMU “Neze Bujani”	62
17.	Shtime	ShMU “Emin Duraku”	764
18.	Ferizaj	ShFMU “Tefik Çanga”	611
19.	Ferizaj	ShFMU “Ismail Qemali”	63
20.	Drenas	ShFMU “Naim Frashëri”	116

Format e ofrimit të edukimit dhe orientimit për karrierë në shkollat partnere


Në tabelën 2. janë paraqitur të dhënat rreth formës së si ofrohet edukimi dhe orientimi në karrierë në shkollat partnere, nëse shkollat pjesëmarrëse kanë këshilltar/e për karrierë dhe se cili është statusi aktual i Klubeve të karrierës.

Tabela 2. Edukimi dhe orientimi në karrierë dhe klubet e karrierës në shkollat respodente

	Shkolla dhe komuna	Si ofrohet edukimi dhe orientimi për karrierë	Këshilltar/e për karrierë në shkollë	Statusi i Klubit të karrierës
1.	ShFMU "Nazim Gafurri", Prishtinë	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"; Njëpërmjet psikologut të shkollës	Jo	Të themeluar dhe funksional
2.	ShFMU "Ibrahim Fehmiu", Prizren	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"; Tema të integruara në lëndë të tjera; Njëpërmjet psikologut të shkollës	Jo	Të themeluar dhe funksional
3.	ShFMU "Pjetër Bogdani", Prishtinë	Tema të integruara në lëndë të tjera; Njëpërmjet psikologut të shkollës	Jo	Të themeluar por jofunksional
4.	ShFMU "Thimi Mitko", Gjilan	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"; Njëpërmjet psikologut të shkollës	Jo	Të themeluar dhe funksional
5.	ShFMU "Liria", Vushtrri	Si koncept në kuadër të "Jeta dhe puna"; Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të themeluar por jofunksional
6.	ShFMU "Rexhep Kadrija", Deçan	Si lëndë zgjedhore "Orientim në karrierë"	Jo	Të themeluar por jofunksional
7.	ShFMU "Ramë Bllaca", Therandë	Si lëndë zgjedhore "Orientim në karrierë"	Jo	Të interesuar për themelim të KK
8.	ShFMU "Xhemail Mustafa", Prishtinë	Si koncept në kuadër të "Jeta dhe puna"; Njëpërmjet këshilltarit për karrierë	Po (është përcaktuar mësimdhënësi, por nuk është miratuar ende nga DKA)	Të interesuar për themelim të KK


9.	ShFMU "Asim Vokshi", Prishtinë	Si koncept në kuadër të "Jeta dhe puna"; Tema të integruara në lëndë të tjera;	Jo	Të themeluar por jofunksional
10	ShFMU "Bedri Gjinaj", Mitrovicë	Si koncept në kuadër të "Jeta dhe puna"; Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të themeluar por jofunksional;
11.	ShFMU "Shaban Jashari", Skenderaj	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"; Tema të integruara në lëndë të tjera; Nëpërmjet këshilltarit për karrierë	Po (kontratë me orar të plotë)	Të themeluar por jofunksional
12.	ShFMU "Selman Riza"	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"; Tema të integruara në lëndë të tjera; Nëpërmjet këshilltarit për karrierë;	Po (është përcaktuar mësimdhënësi, por nuk është miratuar ende nga DKA)	Të themeluar dhe funksional
13.	ShFMU "Zija Shemsiu:, Gjilan	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"	Jo	Të themeluar dhe funksional
14.	ShFMU "Anton Zako Çajupi", Mitrovicë	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna" Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të themeluar dhe funksional
15.	ShFMU "Emin Duraku", Pishtinë	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna" Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të themeluar dhe funksional
16.	ShFMU "Neze Bujani", Lipjan	Lëndë zgjedhore	Jo	Të themeluar por jofunksional
17.	ShMU "Emin Duraku", Shtime	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna" Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të themeluar por jofunksional
18.	ShFMU "Tefik Çanga", Ferizaj	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna" Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të themeluar dhe funksional
19.	ShFMU "Ismail Qemali", Ferizaj	Lëndë zgjedhore	Jo	Të themeluar por jofunksional
20.	ShFMU "Naim Frashëri", Drenas	Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna" Tema të integruara në lëndë të tjera	Jo	Të interesuar për themelim të KK

Sipas këtyre të dhënave, në shumicën e shkollave apo 15 sosh (shih grafikun 1.), edukimi dhe orientimi në karrierë ofrohet si koncept në kuadër të fushës “Jeta dhe puna”, në 11 shkolla ofrohet si temë e integruar në lëndë tjera, në 5 shkolla ofrohen nga psikologu i shkollës, në 3 shkolla nga këshilltari/ja për karrierë dhe në 4 shkolla ofrohet si lëndë zgjedhore.




Grafiku 1. Forma e ofrimit të edukimit dhe orientimit për karrierë

Të dhënat tregojnë se shumica e shkollave partnere apo 17 prej tyre (85%) nuk kanë këshilltar/e për karrierë, derisa 3 shkolla apo 15% kanë të angazhuar këshilltar/e për karrierë (shih Grafikun 2). Duke marrë parasysh mungesën e këshilltarëve për karrierë në shumicën e shkollave, është e rekomandueshme që shkollat të marrin masa për të siguruar mbështetje shtesë në këtë fushë.



Grafiku 2. Këshilltar/e për karrierë në shkollë


Në pyetjen se cili është statusi i Klubit të karrierës në shkollat pjesëmarrëse (a e kanë të themeluar Klubin, a është funksional apo duan ta themelojnë?), 8 shkolla (40%) e kanë të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional, 9 të tjera (45%) e kanë të themeluar por nuk është funksional dhe 3 shkolla (15%) kanë shprehur interesim për themelimin e Klubit të karrierës (shih grafikun 3).



Grafiku 3. Statusi i Klubit të karrierës

Shumica e klubeve të karrierës në shkollat partnere kanë hapësirën e vet për takime dhe aktivitete. Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun 4, 13 klube të karrierës e kanë

hapësirën për takime dhe aktivitete derisa 7 klube nuk kanë. Shkollat që nuk kanë hapësirë të dedikuar për takime dhe aktivitete të Klubit të karrierës mund të marrin në konsideratë nevojën për të krijuar këtë infrastrukturë. Hapësirat e dedikuara mund të ndihmojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve dhe efektivitetit të aktiviteteve të Klubit të karrierës.



Grafiku 4. Hapësirë e dedikuar për takime dhe aktivitete të KK

Statusi dhe nevojat e Klubeve të karrierës në shkollat pjesëmarrëse

1. ShFMU “Nazim Gafurri”, Prishtinë

Shkolla “Nazim Gafurri” në Prishtinë e ka të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional. Ky klub është themeluar në vitin 2020 dhe udhëhiqet nga mësimdhënësi i fushës “Jeta dhe puna”.

Momentalisht, **Klubi ka 20 anëtarë** dhe ka hapësirën e vet për takime dhe aktivitete. Klubi nuk bazohet në ndonjë plan vjetor për realizimin e aktiviteteve.

Aktivitetet kryesore të klubit janë: *ligjërata informuese, takimet me punëdhënësit të ftuar si folës, diskutime/debate për tema të orientimit në karrierë, vlerësimi i interesave,*

talenteve, vlerave të nxënësve, etj., punëtori të ndryshme, takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë dhe panairë të karrierës.

Drejtoresha e kësaj shkolle shprehet se janë mesatarisht të kënaqur me interesimin e nxënësve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit përdorin *rrëfimet e suksesit dhe fushatat vetëdijesuese* për zhvillimin apo rritjen e popullaritetit të klubit. Shkolla përdor *ueb-faqen e shkollës dhe Facebook-un* për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës.

Marrëdhënia e shkollës me komunitetin e biznesit dhe interesimi i bizneseve për bashkëpunim me shkollën vlerësohen si jo të kënaqshme. Kjo shkollë organizon vizita në kompani të ndryshme dhe **nuk ka buxhet të ndarë** për funksionimin e Klubit. Shpenzimet mbulohen nga vetë nxënësit. Kësisoj, sfidat më të mëdha që kanë në funksionimin e Klubit të karrierës janë *financat dhe mosbashkëpunimi me komunitetin e biznesit*. Shkolla vlerëson se mund të sigurojë përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetin e biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës në nivel të kënaqshëm.

2. ShFMU “Ibrahim Fehmiu”, Prizren

Shkolla “Ibrahim Fehmiu” në Prizren e ka të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional. Ky klub është themeluar në **maj të vitit 2020** dhe **udhëhiqet nga mësimmthënësi i fushës “Jeta dhe puna”**. Momentalisht, **Klubi ka 15 anëtarë** dhe ka hapësirën e vet për takime dhe aktivitete. Klubi funksionon duke u bazuar në planin e veprimit.

Klubi kryesisht organizon aktivitete si: *ligjërata informuese dhe diskutime/debate për tema të orientimit në karrierë.*

Sipas të dhënave të pyetësorit, kjo shkollë është e kënaqur me interesimin e nxënësve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit përdorin këto strategji për rritjen e popullaritetit të klubit: *promovimin e aktiviteteve nëpërmjet broshurave/posterëve, prezantimi i aktiviteteve gjatë orëve*

mësimore dhe ngjarjeve të tjera, vizitave në kompani, rrëfimeve të suksesit dhe fushatave vetëdijesuese. Shkolla përdor ueb faqen e shkollës dhe Viber-in për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës.

Marrëdhënien e shkollës me komunitetin e biznesit dhe interesimin e bizneseve për bashkëpunim me shkollën i vlerësojnë si të kënaqshme. Deri tani, klubi i karrierës ka vendosur bashkëpunim me pesë (5) kompani. Kompanitë kanë qenë të përfshira në panairin e organizuar në hollin e shkollës, me ftesë të Klubit të Karrierës ku janë prezantuar profesionet e ndryshme para nxënësve të kl. 8 dhe 9. Në pyetjen nëse Klubi i karrierës ka buxhet të parashikuar për aktivitetet e planifikuara (p.sh. për vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, etj.), thuhet se kjo **shkollë ka ndarë 2030 euro** për aktivitetet vjetore të klubit. Buxheti i ndarë mundëson mbulimin e shpenzimeve për transport gjatë vizitave në biznese, derisa nga shkolla shprehen se shpenzimet tjera mundohen t'i mbulojnë nga donacionet e kompanive dhe të OJQ-ve. *“Duke marrë parasysh buxhetin e vogël, ne mund të mbulojmë vetëm udhëtimin me autobus. Planifikojmë që t'i mbulojmë shpenzimet me donacione nga kompanitë private apo OJQ”* (Drejtori 2). Kësisoj, sfidat më të mëdha që kanë në funksionimin e Klubit të karrierës janë: *financat, mosbashkëpunimi me klubet tjera të karrierës dhe mungesa e informatave për tregun e punës.* Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetin e biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

3. ShFMU “Pjetër Bogdani”, Prishtinë

Klubi i karrierës në shkollën “Pjetër Bogdani” është themeluar në **maj të vitit 2020** dhe ishte funksional deri në **shtator të vitit 2023**. Gjatë kësaj kohe, Klubi është udhëhequr nga arsimtarja e lëndës së Gjeografisë. Nga shkolla shprehen se arsyet e mosfunksionimit të Klubit janë: *mungesa e hapësirës së dedikuar për aktivitete e Klubit si dhe mosinteresimi i kompanive/profesionistëve për bashkëpunim.* Kjo shkollë është më se e interesuar ta rifunksionalizojë Klubin e karrierës. Për aq kohë sa ka funksionuar Klubi

i karrierës, aktivitetet kryesore të Klubit të karrierës ishin: *ligjëratat informuese, debatet/diskutimet për tema të orientimit në karrierë dhe punëtori të tjera.*

Në përgjithësi në këtë shkollë menaxhmenti është i kënaqur me interesimin e nxënësve, por jo edhe me interesimin e bizneseve për bashkëpunim me shkollën. Menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit kanë përdorur këto strategji për zhvillimin apo rritjen e popullaritetit të klubit: *promovimi i aktiviteteve nëpërmjet broshurave/posterëve si dhe prezantimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera.* Kjo shkollë planifikon që të përdorë platformat *Facebook dhe Instagram* për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Klubi i karrierës nuk ka vendosur bashkëpunim me ndonjë kompani, dhe **nuk ka buxhet** të ndarë për aktivitetet e Klubit. *“Vitin e kaluar ka qenë një organizim njëditorë i prezantimeve të profesioneve të ndryshme i cili është mbajtur në shkollë”* (Drejtori 3). Kjo shkollë planifikon që shpenzimet e Klubit t'i mbulojë me donacione.

Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetin e biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

4. ShFMU “Thimi Mitko”, Gjilan

Shkolla “Thimi Mitko” në Gjilan e **ka të themeluar** Klubin e karrierës dhe është funksional. Ky klub është themeluar në **vitin 2020** dhe udhëhiqet nga pedagogu i shkollës. Momentalisht, **Klubi ka 16 anëtarë** por **nuk ka hapësirë** të dedikuar për takime dhe aktivitete të veta. Klubi nuk ka plan vjetor të punës.

Klubi kryesisht organizon aktivitete si: *ligjëratat informuese, punëtori të ndryshme, takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë, panairë të karrierës, ofron këshillim në karrierë si dhe vizita në shkolla profesionale ose biznese lokale.*

Drejtoresha e kësaj shkolle shprehet mesatarisht e kënaqur me interesimin e nxënësve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit përdorin këto strategji për rritjen e popullaritetit të klubit: *prezantimin e aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera, vizita në kompani lokale dhe*

promovimin në rrjete sociale. Shkolla përdor ueb-faqen e shkollës, platformën Facebook dhe revistën e shkollës për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Niveli i marrëdhënies së bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet si mesatarisht i kënaqshëm e kështu edhe interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën. Klubi i karrierës ka bashkëpunim me tri (3) kompani, të cilat ofrojnë mundësi të vizitave të nxënësve në hapësirat e tyre, por edhe ofrojnë produktet ushqimore falas gjatë ngjarjeve dhe festave të shkollës. “Në vizitat e nxënësve tanë në kompanitë, bizneset lokale, por edhe bizneset lokale na vizitojnë neve dhe sjellin produktet e tyre ushqimore nëpër festa të shkollës p.sh në festën e Abetares, në ditën e parë të shkollës, etj.” (Drejtori 4). Klubi i karrierës nuk ka buxhet të parashikuar për aktivitetet e planifikuara dhe mbështetje të vetme ka pasur trajnimet nga GIZ dhe donacionet nga bizneset lokale.

Sfidat që pamundësojnë funksionimin më efektiv të Klubit janë: *financat, bashkëpunimi me komunitetin e biznesit si dhe mungesa e informatave për tregun e punës.* Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës, derisa në nivel mesatar atë të përfshirjes së prindërve në aktivitete të KK. Megjithatë, vlerësohet si sfidë sigurimi i përfshirjes së komunitetit e biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

5. ShFMU “Liria”, Vushtrri

Klubi i karrierës në shkollën “Liria” është themeluar në **tetor të vitit 2020** dhe ishte funksional deri në vitin **2022**. Klubi ishte **udhëhequr nga mësimdhënësi i fushës “Jeta dhe puna”**. Arsyet që kanë çuar në mosfunksionimin e klubit janë: *mungesa e buxhetit si dhe mungesa e trajnimit të udhëheqësve për realizimin e aktiviteteve.* Nga shkolla shprehen se janë më se të interesuar ta rifunksionalizojnë klubin e karrierës. Derisa klubi ishte funksional, për nxënësit janë ofruar këto aktivitete: *ligjërata informuese, takime me punëdhënësit/të ftuar si folës, diskutime/debate për tema të orientimit në karrierë, vlerësimi i interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, etj., takime me prindërit rreth*

temave të edukimit dhe orientimit në karrierë, panairë të karrierës dhe këshillim në karrierë.

Në pyetësor shprehen se janë të kënaqur me interesimin e nxënësve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Megjithatë, vlerësohet si mesatarisht i mirë niveli i marrëdhënies së bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit, derisa si i pakënaqshëm vlerësohet interesimi i bizneseve për bashkëpunim me Klubin e Karrierës. Menaxhmenti i shkollës si dhe sekretariati i klubit pajtohen të përdorin të gjitha strategjitë opsionale për të promovuar aktivitetet e klubit dhe për të rritur popullaritetin e tij, si: *promovimin e aktiviteteve nëpërmjet broshurave/posterëve, prezantimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera, vizita në kompani lokale, artikuj të shkruar pas ngjarjeve të organizuara, rrëfime suksesi si dhe fushata vetëdijesuese.* Klubi i karrierës planifikon të përdorë TV-në, platformën *Facebook, Instagram, LinkedIn* dhe revistën e shkollës për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Klubi i karrierës bashkëpunoi me tri (3) kompani të cilat ofruan vizita të nxënësve dhe ligjërata të ndryshme. Klubi i karrierës **nuk ka buxhet të parashikuar** për aktivitetet e planifikuara dhe mbështetje të vetme e konsideron angazhimin vullnetar të komunitetit të biznesit/profesionistëve. Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

6. ShFMU “Rexhep Kadrija”, Deçan

Në shkollën “Rexhep Kadrija”, Klubi i karrierës është themeluar **në vitin 2022**, dhe ishte funksional deri në **shtator të vitit 2023**. Klubi i karrierës ishte **udhëhequr nga vetë nxënësit** e shkollës. Disa nga arsyet që kanë sjellë në mosfunksionimin e Klubit janë: *mungesa e udhëheqësit, mungesa e hapësirës së dedikuar dhe mungesa e trajnimit të udhëheqësit/ve për realizimin e aktiviteteve.* Kjo shkollë është e interesuar ta rifunksionalizojë Klubin e karrierës. Për aq kohë sa ka funksionuar Klubi i karrierës, aktivitetet kryesore të Klubit ishin: *ligjëratat informuese, ofrimi i sesioneve të vlerësimit të interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, etj., punëtori të ndryshme si dhe takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë.* Koordinator i

cilësisë i kësaj shkolle shprehet se janë mesatarisht të kënaqur me interesimin e nxënësve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Niveli i marrëdhënies së bashkëpunimit të shkollës dhe komunitetit të biznesit vlerësohet mesatar, e po ashtu edhe interesimi i bizneseve për bashkëpunim me shkollën. Menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit, planifikojnë të bëjnë *prezantimin e aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera dhe vizita në kompani* lokale me qëllim që të zhvillojnë dhe rrisin popullaritetin e klubit. Ueb-faqja e shkollës dhe platforma *rrjeti social "Facebook"* planifikohet do të përdoren për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Klubi i karrierës pati vendosur bashkëpunim me tri (3) kompani. Në anën tjetër, ky klub ka funksionuar pa buxhet të ndarë për aktivitete. Në pyetjen se si planifikojnë që t'i mbulojnë shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të Klubit, nga administratorët thuhet se *aktivitetet planifikohen të organizohen vullnetarisht me ndihmën e arsimtares së lëndës zgjedhore "Orientim në karrierë"*. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë në nivel të lartë përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, derisa në anën tjetër përfshirja e prindërve dhe komunitetin e biznesit shihet si më sfiduese.

7. ShFMU "Ramë Bllaca", Suharekë

Shkolla "Ramë Bllaca" në Suharekë ka shprehur interesim për themelimin e Klubit të karrierës. Në pyetjen se cilat kanë qenë arsyet që kanë penguar themelimin e Klubit, thuhet se ka **hezitim nga mësimdhënësit** për ta udhëhequr klubin për arsye të mungesës së kualifikimit adekuat. Drejtoresha e kësaj shkolle shprehet se për klubin e karrierës ekziston hapësira e dedikuar për takime dhe aktivitete, dhe se janë të vendosur që për aktivitetet e ardhshme të klubit të ndajnë **buxhet vjetor (500 euro)** dhe të angazhohen për sigurimin e donacioneve. Niveli i marrëdhënies së shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet si i kënaqshëm, por në anën tjetër jo të kënaqshëm e vlerësojnë interesimin e bizneseve për bashkëpunim me shkollën rreth aktiviteteve të Klubit të karrierës.

Më tej thuhet se shkolla është e gatshme të iniciojë bashkëpunim me dy kompani pas themelimit të Klubit si dhe të përfshijë komunitetin e biznesit në organizimin e vizitave

dhe trajnimeve të ndryshme. Aktivitetet e Klubit të karrierës planifikohen të promovohen nëpërmjet platformës *Facebook*.

Sa i përket sfidave me të cilat mund të ballafaqohet shkolla në funksionimin e mirëfilltë të Klubit të karrierës, thuhet se këto mund të jenë: *mungesa e financave, bashkëpunimi me komunitetin e biznesit dhe Klubet e tjera të karrierës*. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit, derisa në anën tjetër përfshirja e prindërve dhe komunitetin e biznesit vlerësohet se mund ta sigurohet nga shkolla në nivel mesatar.

8. ShFMU “ Xhemail Mustafa”, Prishtinë

Shkolla “Xhemail Mustafa” është njëra prej tri shkollave pjesëmarrëse në projekt **që ka deklaruar se ka këshilltar për karrierë**. Sipas drejtoreshës së kësaj shkolle, mësimdhënësja e TIK është përcaktuar për pozitën e këshilltares për karrierë dhe emri saj është dërguar në DKA, por ende nuk është miratuar.

Kjo shkollë **nuk ka Klub të karrierës** i cili është funksional dhe nëpërmjet pyetësorit është treguar interesimi për themelimin e tij. Pas kontaktimit me telefon, drejtoresha ka sqaruar se Klubi është themeluar në vitin 2020, por asnjëherë nuk ka qenë funksional. Mësimdhënësi i TIK tashmë ka përcaktuar disa nxënës që do të jenë anëtarë të sekretariatit të Klubit. Kjo shkollë nuk ka raportuar në pyetësor ndonjë sfidë të hasur në themelimin e Klubit. Planifikohet që pas themelimit, shpenzimet për aktivitetet e Klubit të karrierës (p.sh. vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, logjistikë, etj.) të **mbulohen nga prindërit**. Shuma e financimit që do të përcaktohet të bëhet nga prindërit, varet nga shpenzimet që do të kërkojnë aktivitetet e planifikuara si p.sh.: shpenzimet e transportit të nxënësve në vizita institucioneve dhe kompanive lokale.

Niveli i marrëdhënies së bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit si dhe interesimi i bizneseve për bashkëpunim me shkollën vlerësohen të kënaqshme. Kjo

shkollë planifikon që pas themelimit të Klubit të iniciojë marrëveshje bashkëpunimi me 3-4 kompani.

Rrjetet sociale ose media të tjera të informimit dhe të komunikimit si *TV-ja, radio, buletinet e shkollës, ueb-faqja e shkollës, platforma Facebook, Instagram dhe revista e shkollës* planifikohen të përdoren për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Sipas këshilltares për karrierë, sfidat me të cilat mund të ballafaqohet shkolla drejt funksionimit efektiv të Klubit janë: *marketingu (promovimi jo i kënaqshëm i aktiviteteve), mungesa e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit dhe klubet tjera të karrierës dhe mungesa e aftësive të nxënësve për menaxhimin e Klubit*. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

9. ShFMU “Asim Vokshi”, Prishtinë

Në shkollën “Asim Vokshi” në Prishtinë, Klubi i karrierës është themeluar në **janar të vitit 2020**, dhe ishte funksional deri në muajin **shtator të vitit 2022**. Ky klub gjatë kohës së funksionimit ishte udhëhequr nga *koordinatorja e cilësisë në shkollë*. Për arsye të **mungesës së udhëheqësit**, ky klub momentalisht nuk është funksional. Kjo shkollë është më se e interesuar ta rifunksionalizojë Klubin e karrierës. Përgjatë kohës sa ka funksionuar, Klubi i karrierës ka organizuar: *ligjërrata informuese, diskutime dhe debate mbi tema të orientimit në karrierë, vlerësimin e interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, etj., punëtori të ndryshme, takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë, panairë të karrierës dhe këshillim në karrierë*. Interesimi i nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e klubit të karrierës ishte shumë i lartë. Nivelin e marrëdhënies së bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit, drejtori i kësaj shkolle e vlerëson mesatar, ndërsa interesimin e komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën. jo edhe aq të kënaqshëm.

Pas rifunksionalizimit të Klubit, kjo shkollë planifikon që aktivitetet e klubit t’i promovojë *nëpërmjet prezantimit të aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve tjera si dhe nëpërmjet rrëfimeve të suksesit*.

Mediat dhe rrjetet sociale si *TV-ja dhe Facebooku* do të përdoren për promovimin e aktiviteteve të klubit të karrierës. Gjatë funksionimit të Klubit, nuk është vendosur bashkëpunim me ndonjë kompani.

Për funksionimin e Klubit të karrierës *nuk është ndarë ndonjëherë buxhet dhe nuk planifikohet*, duke qenë se aktivitetet gjithmonë janë realizuar nëpërmjet mjeteve vetanake të prindërve. Kjo shkollë zotohet se mund të sigurojë në nivel të lartë përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

10. ShFMU “Bedri Gjinaj”, Mitrovicë

Klubi i karrierës në shkollën “Bedri Gjinaj” është themeluar më **12 mars të vitit 2022**. Sipas koordinatores së cilësisë në këtë shkollë, ky klub **ishte funksional deri më 25 tetor 2023**. Klubi ishte **udhëhequr nga mësimdhënësja e fushës “Jeta dhe puna”**. Në anën tjetër, drejtori i shkollës tregon se ky klub nuk është funksional mbi të gjitha për shkak të mungesës së këshilltarit për karrierë.

Kjo shkollë është më se e interesuar ta rifunksionalizojë Klubin e karrierës dhe planifikon të **ndajë 500 euro buxhet** për aktivitetet vjetore. Po ashtu, për klubin ekziston edhe hapësira e dedikuar për takime dhe aktivitete. Për aq kohë sa Klubi ishte funksional, janë organizuar: *ligjëratat informuese, diskutime mbi tema të orientimit në karrierë, dhe takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë*.

Niveli i bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet mesatar, ashtu si edhe interesimi i bizneseve për bashkëpunim me shkollën. Kjo shkollë planifikon, që pas rifunksionalizimit të Klubit, të iniciojë bashkëpunim me katër kompani. Këto kompani do të përfshihen në aktivitetet e Klubit nëpërmjet takimeve dhe prezantimit të ideve të nxënësve të shkollës për bashkëpunim. Aktivitetet e Klubit planifikohen të promovohen në: *TV, ueb-faqen e shkollës, Facebook, Instagram dhe në revistën e shkollës*. Sipas drejtori të shkollës, sfidat me të cilat mund të ballafaqohet shkolla për funksionalizimin e Klubit janë: *mungesa e financave dhe e bashkëpunimit me komunitetin*

e *biznesit*. Nga kjo shkollë zotohen se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

11. ShFMU “Shaban Jashari”, Skenderaj

Shkolla “Shaban Jashari” në Skenderaj është e dyta shkollë partnere në këtë projekt që **ka këshilltar për karrierë**. Këshilltari për karrierë është angazhuar para katër muajsh me kontratë për punë me orar të plotë. Për më shumë, pas bisedës me këshilltarin për karrierë, ai sqaroi se pas kërkesës nga MASHTI për angazhimin e këshilltarit për karrierë, kjo shkollë ka përcaktuar personin i cili është vlerësuar më kompetent për këtë pozitë (kualifikim MA-Edukim), dhe është caktuar kodi buxhetor për angazhimin e tij.

Klubi i karrierës në këtë shkollë është themeluar në **fillim të vitit 2023**, dhe ishte funksional deri në **shtator të vitit 2023**. Si arsye e ndërprerjes së funksionimit ceket **mungesa e buxhetit**. Ky Klub ishte udhëhequr nga këshilltari për karrierë. Kjo shkollë është e interesuar ta rifunksionalizojë Klubin e karrierës. Për aq kohë sa ishte funksional, ky klub ka organizuar: *diskutime/ debate mbi tema të orientimit në karrierë si dhe takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë*. Niveli i interesimit të nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e Klubit të karrierës ishte në nivel të kënaqshëm. Marrëdhënia e bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet e kënaqshme, ndërsa interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën vlerësohet në nivel jo të kënaqshëm. Kjo shkollë planifikon të përdorë strategji të ndryshme për rritjen e popullaritetit të Klubit dhe promovimin e aktiviteteve të tij si nëpërmjet *prezantimit të aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera dhe me vizita në kompani lokale. Ueb-faqja dhe platforma Facebook do të përdoren për promovimin e aktiviteteve të nxënësve dhe publiku i gjerë*.

Kjo shkollë ka bashkëpunim me shkollat profesionale dhe fabrika të ndryshme. Përfshirja e kompanive planifikohet të realizohet duke i prezantuar në klasa. Kjo shkollë planifikon të ndajë buxhet për aktivitete, por kjo varet nga qëllimi i aktivitetit. Po ashtu,

shpenzimet tjera planifikohet të mbulohen edhe me donacione nga komuniteti dhe kompanitë. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë në nivel mesatar përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të Karrierës.

12. ShFMU “Selman Riza”, Gjakovë

Shkolla “Selman Riza” në Gjakovë e ka të *themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional*. Ky klub është themeluar në **vitin 2017** dhe **udhëhiqet nga mësimmshënësi i fushës “Jeta dhe puna”**. Momentalisht, **Klubi ka 15** anëtarë (nxënës të klasave të 6-ta deri 9-ta) dhe ka hapësirën e vet për takime dhe aktivitete. Klubi funksionon duke u bazuar në planin e veprimit. Shkolla “Selman Riza” është e treta shkollë partnere në këtë projekt që ka këshilltar për karrierë.

Klubi organizon të gjitha aktivitetet që janë ofruar në pyetësor si opsione, e këto janë: *ligjërata informuese, takime me punëdhënës/të ftuar si folës, diskutime/debate për tema të orientimit në karrierë, vlerësimi i interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, punëtori të ndryshme, takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë, panairë të karrierës dhe këshillim në karrierë*.

Drejtori i kësaj shkolle shprehet se janë të kënaqur me interesimin e nxënësve për t’u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit përdorin këto strategji për rritjen e popullaritetit të klubit: *promovimin e aktiviteteve nëpërmjet broshurave/posterëve, prezantimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore dhe ngjarjeve të tjera, vizitave në kompani, rrëfimeve të suksesit dhe fushatave vetëdijesuese*. Shkolla përdor *TV-në, buletin e shkollës dhe platformën Facebook* për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës.

Marrëdhënia e bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet si e kënaqshme, derisa komunitetin e biznesit e vlerësojnë si mesatarisht të interesuar për bashkëpunim me shkollën. Deri tani, klubi i karrierës *ka vendosur bashkëpunim me pesë (5) kompani*. Kompanitë janë të përfshira në aktivitetet e Klubit të karrierës nëpërmjet

vizitave në hapësirat e tyre si dhe promovimin e profileve të kompanive në shkollë. Në pyetjen nëse Klubi i karrierës ka buxhet të parashikuar për aktivitetet e planifikuara (p.sh. për vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, etj.), thuhet se kjo **shkollë nuk ka buxhet** për aktivitetet vjetore të klubit. Thuhet se për aktivitetet brenda shkollës, shpenzimet mbulohen me buxhetin e shkollës, ndërsa për vizita jashtë shkollës, shpenzimet e udhëtimit i mbulojnë vetë nxënësit. Kësisoj, sfidat më të mëdha që kanë në funksionimin e Klubit të karrierës janë *financat, mungesa e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit dhe mungesa e aftësive të nxënësve për menaxhimin e Klubit*. Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës, derisa përfshirjen e prindërve dhe të komunitetit të biznesit e vlerësojnë mesatarisht të arritshëm.

13. ShFMU “Zija Shemsiu”, Gjilan

Shkolla “Zija Shemsiu” në Gjilan e ka të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional. Ky klub është themeluar në **vitin 2021** dhe **udhëhiqet prej koordinatorit për cilësi**. Momentalisht, **Klubi ka 22 anëtarë** (nxënës të klasave të 7-ta, 8-ta dhe 9-ta) dhe **ka hapësirën e vet** për takime dhe aktivitete. Klubi *funksionon duke u bazuar në planin e veprimit*.

Klubi është kryesisht i fokusuar në ofrimin vetëm të një shërbimi e që është **këshillimi në karrierë**. Këshillimi për karrierë (nëpërmjet bisedës me nxënësit) ofrohet nga sekretariati i Klubit, në bashkëpunim me mësime dhënësin mentor. Drejtori shprehet se kanë mungesë të mjeteve dhe instrumenteve konkrete për realizimin e këshillimit. Drejtori i kësaj shkolle shprehet se janë mesatarisht të kënaqur me interesimin e nxënësve për t’u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Menaxhmenti i shkollës dhe sekretariati i Klubit përdorin *prezantimin e aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera* për të promovuar aktivitetet e Klubit të karrierës. Shkolla përdor vetëm *TV-në (sëqarim: mund të bëhet fjalë për televizor të vendosur në hapësirat e shkollës)* për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës. Marrëdhënia e bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohen mesatarisht e kënaqshme, ndërsa komunitetin e

biznesit e vlerësojnë si mesatarisht të interesuar për bashkëpunim me shkollën. Klubi i karrierës është në kërkim të kompanive të cilat shprehin interesim për bashkëpunim. Kryesisht, komuniteti i biznesit është i përfshirë gjatë përfundimit të klasës së 9-të nëpërmjet panairit të shkollave profesionale të organizuara nga DKA-ja. Në pyetjen nëse Klubi i karrierës ka buxhet të parashikuar për aktivitetet e planifikuara (p.sh. për vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, etj.), thuhet se kjo **shkollë nuk ka buxhet** për aktivitetet vjetore të klubit. Në pyetjen se si planifikojnë t'i mbulojnë shpenzimet në të ardhmen, thuhet se shpenzimet për aktivitetet do të mbulohen me buxhetin e shkollës. Kësisoj, **sfidat më të mëdha** që kanë në funksionimin e Klubit të karrierës janë **financat**. Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës, ndërsa përfshirjen e prindërve dhe komunitetin e biznesit e vlerësojnë si shumë vështirë të arritshme.

14. ShFMU “Anton Zako Çajupi”, Mitrovicë

Klubi i karrierës në shkollën “Anton Zako Çajupi” është themeluar në **vitin 2023**. Ky klub **udhëhiqet prej nxënësve të shkollës**. E përbëjnë **12 anëtarë dhe mësimsdhënësi mentor**. Klubi posedon hapësirën për takime dhe aktivitete. Sa i përket planit vjetor të punës së Klubit të karrierës, thuhet se ky plan do të rishikohet. Aktivitetet kryesore të Klubit janë: *diskutime/ debate për tema të orientimit në karrierë, vlerësimi i interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, punëtori të ndryshme dhe takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë*. Në pyetjen e pyetësorit rreth nivelit të kënaqshmërisë me interesimin e nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e Klubit të karrierës, thuhet se kjo shkollë është e kënaqur me interesimin e deritashëm të nxënësve. Për promovimin dhe ngritjen e popullaritetit të aktiviteteve të Klubit, shkolla përdor disa strategji, si: *prezantimin e aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera, vizita në kompani lokale dhe artikuj të shkruar pas ngjarjeve të organizuara*. Kjo shkollë promovon aktivitetet e Klubit nëpërmjet *platformës Facebook dhe revistës së shkollës*. Nivelin e marrëdhënies së shkollës me komunitetin e biznesit e vlerësojnë mesatarisht të

kënaqshëm, ndërsa komunitetin e biznesit e vlerësojnë pak të interesuar për bashkëpunim me shkollën. Klubi i karrierës ka bashkëpunim me katër (4) kompani, të cilat janë të përfshira në aktivitetet e klubit. Shkolla bashkëpunon me shkollat profesionale dhe organizon vizita në hapësirat e tyre, informon nxënësit për profilet nëpërmjet fletëpalosjeve dhe ligjëratave. Në anën tjetër, kompanitë ndërtimore ofrojnë ligjërata, vizita, ndërsa organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare ofrojnë ligjërata për punë vullnetare, punëtori, panaire, etj. Klubi i karrierës **nuk ka buxhet**, ndërsa nga shkolla thonë se me aq mundësi sa kanë, Klubi furnizohet me materiale shpenzuese nga shkolla, por edhe me iniciativa vetanake. Po planifikohet që të bëhet kërkesë që për Klubin të mundësohet buxhet nga komuna ose nga organizatat. Sfidat me të cilat ballafaqohet Klubi i karrierës janë: *mungesa e financave, mungesa e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit dhe mungesa e informatave për tregun e punës*. Nga shkolla vlerësojnë se mund të sigurojnë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës, përfshirjen e prindërve mund ta sigurojnë në nivelin mesatar ndërsa përkrahjen dhe përfshirjen e komunitetin e biznesit i vlerësojnë si më sfiduese.

15. ShFMU “Emin Duraku”, Prishtinë

Klubi i karrierës në shkollën “Emin Duraku”, në Prishtinë është funksional prej **vitit 2020**, dhe **udhëhiqet nga koordinatori i cilësisë**. Klubi ka **15 anëtarë** dhe posedon hapësirën e vet për takime dhe aktivitete. Klubi nuk ka plan vjetor të punës. Kryesisht, Klubi organizon *ligjërata informuese dhe diskutime/debate për tema të orientimit në karrierë*. Kjo shkollë është e kënaqur me interesimin e nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e Klubit. Për të promovuar aktivitetet e Klubit, por edhe popullaritetin e tij, shkolla prezanton aktivitetet gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera si dhe organizon fushata vetëdijesuese. Kjo shkollë përdor rrjetet sociale dhe media të tjera të informimit dhe të komunikimit për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës, si: *ueb faqen e shkollës dhe platformën Facebook*. Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet i kënaqshëm, po kështu edhe interesimi i komunitetit të biznesit për

bashkëpunim me shkollën. Deri më tani Klubi i karrierës ka bashkëpunim me dy kompani, kryesisht media dhe kompani ndërtimore. Klubi i karrierës **nuk ka buxhet** vetanak, por nga shkolla shprehen se kanë parashikuar **2000 euro** për shpenzimet e Klubit. Sfidë e vetme vlerësohen financat. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë përkrahjen dhe përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në nivel të kënaqshëm.

16. ShFMU “Neze Bujani”, Lipjan

Klubi i karrierës në shkollën “Neze Bujani” në Lipjan është themeluar në **dhjetor të vitit 2022**, dhe ishte funksional deri në **vitin 2023**. Ky Klub është **udhëhequr nga nxënësit**. Kjo shkollë është e interesuar ta rifunksionalizojë Klubin. Për atë kohë sa ishte funksional, Klubi i karrierës ka organizuar *diskutime/ debate për tema të orientimit në karrierë, punëtori të ndryshme, takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë dhe panairë të karrierës*. Niveli i interesimit të nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e Klubit të karrierës vlerësohet i kënaqshëm. Po ashtu, niveli i bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet i kënaqshëm, derisa interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën vlerësohet mesatar. Kjo shkollë përdor strategjinë e artikujve të shkruar pas ngjarjeve të organizuara për të promovuar aktivitetet e Klubit. Në anën tjetër, *Facebooku dhe revista e shkollës* janë mjetet e komunikimit që përdoren nga shkolla për të informuar nxënësit, stafin dhe palë të tjera rreth aktiviteteve dhe mundësive që ofron Klubi. Nga shkolla thuhet se Klubi i karrierës nuk ka bashkëpunuar me asnjë kompani në asnjë formë që mund të ofrohet si shembull. Klubi i karrierës nuk ka buxhet dhe nuk është planifikuar të ketë. Shpenzimet mbulohen nga të ardhurat individuale. Kjo shkollë mund të sigurojë në nivel të kënaqshëm përfshirjen e nxënësve dhe të komunitetit të biznesit, ndërsa në nivel mesatar përfshirjen dhe përkrahjen e prindërve.

17. ShMU “Emin Duraku”, Shtime

Shkolla “Emin Duraku” në Shtime e ka themeluar Klubin e karrierës në **vitin 2023**, por *nuk ka funksionuar*. Ky klub është **udhëhequr nga nxënësit**. Disa nga arsyet e mosfunksionimit të Klubit ishin: *mungesa e hapësirës së dedikuar, mungesa e trajnimit të udhëheqësit/ve për realizimin e aktiviteteve dhe mungesa e buxhetit*. Kjo shkollë është më se e interesuar të rifunksionalizojë Klubin e karrierës. Për aq kohë sa ka funksionuar ky klub ka organizuar vetëm ligjërata informuese. Kjo shkollë është e kënaqur me interesimin e nxënësve për pjesëmarrje në aktivitete. Niveli i bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit vlerësohet i kënaqshëm, e po ashtu i kënaqshëm vlerësohet edhe interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën.

Kjo shkollë planifikon që të përdorë *rrëfimet e suksesit si strategji* për të rritur popullaritetin e Klubit të karrierës. Po ashtu, planifikohen të përdoren këto mjete të informimit dhe komunikimit për të promovuar aktivitetet e Klubit të karrierës: *ueb-faqja e shkollës, Facebook, Instagram dhe revista e shkollës*. Duke qenë se Klubi i karrierës në këtë shkollë nuk ka funksionuar pas themelimit, kjo shkollë nuk ka vendosur bashkëpunim me ndonjë kompani. Ky klub **nuk ka buxhet** vetanak dhe nuk është planifikuar buxhet për periudhën vijuese duke qenë se ishte jofunksional. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë në nivel të kënaqshëm përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

18. ShFMU “Tefik Çanga”, Ferizaj

Klubi i karrierës në shkollën “Tefik Çanga” në Ferizaj është themeluar në **tetor të vitit 2023** dhe **udhëhiqet nga mësimdhënësja e fushës “Jeta dhe puna”**. Momentalisht, Klubi i ka **10 anëtarë** dhe *posedon hapësirën për takime dhe aktivitete*. Po ashtu, Klubi funksionon duke u bazuar në planin vjetor. Aktivitetet kryesore të klubit janë: *ligjëratat informuese, diskutimet/debatet për tema të orientimit në karrierë dhe takimet me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë*. Drejtori i shkollës shprehet

mesatarisht i kënaqur me interesimin e nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e Klubit. Kjo shkollë përdor *prezantimet e aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera, artikuj të shkruar pas ngjarjeve të organizuara dhe fushatat vetëdijesuese për të zhvilluar dhe rritur popullaritetin e tij*. Ndër të tjera, shkolla përdorë *buletinet dhe revistën e shkollës për të promovuar aktivitetet e Klubit*.

Nivelin e bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit e vlerësojnë mesatarisht të kënaqshëm, po kështu mesatar vlerësohet edhe interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën. Në pyetjen se me sa dhe me cilat kompani bashkëpunojnë, thuhet se shkolla bashkëpunon me kompanitë e prindërve të nxënësve që janë 5 të tilla. Këto kompani nuk janë përfshirë në aktivitetet e Klubit të karrierës, por në forma të tjera e kanë mbështetur shkollën. Klubi **nuk ka buxhet vetanak** dhe nuk është planifikuar buxhet për periudhën vijuese. Në pyetjen se si planifikojnë të mbulojnë shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të Klubit, thuhet se ato do të realizohen me punë vullnetare të ekipit. Sfidat me të cilat ballafaqohet Klubi janë *mungesa e marketingut apo promovimit të aktiviteteve, mungesa e informatave për tregun e punës dhe interesimi jo i duhur i komunitetit të prindërve për orientimin në karrierë*. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë mesatarisht përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

19. ShFMU “Ismail Qemali”, Ferizaj

Klubi i karrierës në shkollën “Ismail Qemali” në Ferizaj është themeluar në **prill të vitit 2022**, dhe ishte funksional deri në **maj të vitit 2023**. Përgjatë kësaj kohe, Klubi ishte udhëhequr nga **menaxhmenti i shkollës**. Arsyeja e mosfunksionimit të klubit, sipas menaxhmentit, është mungesa e hapësirës së dedikuar. Kjo shkollë është më se e interesuar për rifunksionalizimin e Klubit të karrierës. Për aq kohë sa Klubi ishte aktiv, u ofruan për nxënësit këto aktivitete dhe shërbime: *ligjërata informuese, diskutime/debate*

mbi tema të orientimit në karrierë, punëtori të ndryshme dhe panairë të karrierës. Kjo shkollë është e kënaqur me interesimin e nxënësve për pjesëmarrje në aktivitetet e Klubit. Niveli i marrëdhënies së bashkëpunimit të shkollës me komunitetin e biznesit, por gjithashtu edhe interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën vlerësohet i kënaqshëm. Kjo shkollë planifikon të vazhdojë të zhvillojë interesimin e nxënësve për Klubin duke prezantuar aktivitetet gjatë orëve mësimore/ngjarjeve të tjera dhe fushatave vetëdijesuese. Rrjeti social Facebook dhe revista e shkollës janë mjetet e informimit dhe të komunikimit që janë përdorur dhe planifikohet të përdoren për promovimin e aktiviteteve të Klubit. Klubi i karrierës ka bashkëpunuar me 2-3 kompani të cilat kanë prezantuar punën e tyre para nxënësve. Po ashtu, ky klub ka pasur buxhet vetanak, përkatësisht 100 euro. Vlerësohet se kjo shkollë mund të sigurojë në nivel mesatar përkrahjen/përfshirjen e nxënësve, prindërve dhe komunitetit të biznesit në aktivitetet e Klubit të karrierës.

20. ShFMU “Naim Frashëri”, Drenas

Shkolla “Naim Frashëri” në Drenas ka shprehur interesim për themelimin e Klubit të karrierës. Në pyetjen nëse kanë pasur sfida në themelimin e Klubit, thuhet sfidat janë të shumta e ndër to ceken mungesa e këshilltarit për karrierë, mungesa e stafit (pedagogut, psikologut) angazhimi i mësimitdhënësës së TI-së si bashkëpunëtore në dy shkolla dhe angazhimin e koordinatores së cilësisë në katër shkolla. Kjo shkollë ka hapësirën e vet për takime dhe aktivitete të Klubit të karrierës. Deri më tani, klubi nuk ka pasur buxhet për aktivitete por nga drejtoresha e shkollës thuhet se në mundësinë e parë, do të kërkojë në mbledhjen e radhës së DKA-së. Kjo shkollë planifikon të ndajë 1000 euro për shpenzimet e Klubit. Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin e biznesit, e gjithashtu edhe interesimi i komunitetit të biznesit për bashkëpunim me shkollën vlerësohen mesatar. Kjo shkollë planifikon të iniciojë bashkëpunim me 5 kompani pas themelimit të Klubit. Do të bashkëpunohet me kompani me të cilat shkolla tashmë ka një njohje të mëhershme të bashkëpunimit. Kjo shkollë planifikon të përdorë këto rrjete sociale dhe media të informimit dhe komunikimit për të promovuar aktivitetet e Klubit

të karrierës: *buletinet e shkollës, ueb faqen e shkollës, Facebook dhe revistën e shkollës*. Sfidat që mund t'i ketë shkolla në funksionimin e Klubit të karrierës vlerësohen të jenë financat, marketingu apo promovimi i aktiviteteve, bashkëpunimi me Klubet tjera të karrierës, etj. Kjo shkollë vlerëson se mund të sigurojë përkrahjen/përfshirjen e nxënësve dhe të prindërve në nivel të kënaqshëm, derisa atë të komunitetit të biznesit, në nivel mesatar.

Tregu i punës dhe aftësitë e kërkuara

Shkollat pjesëmarrëse në anketim janë pyetur se cilat janë sektorët e industrive që janë në rritje ose në zhvillim në komunën e tyre (shih tabelën 3). Disa prej sektorëve më të kërkuara sipas shkollave respondente janë sektori i TI-, së, prodhimit, tregtisë, inxhinierisë, gastronomisë, tekstilit, pijeve, mobilierive, etj. Disa prej aftësive/shkathtësive që shkollat vlerësojnë se kërkohen nga tregu i punës janë njohuritë akademike dhe aftësitë e buta si aftësitë digjitale, njohja e gjuhëve të huaja, aftësitë në shitje dhe shërbime, aftësitë e komunikimit, organizimit, puna ekipore, kreativiteti, e të tjera.

Tabela 3. Tregu i punës dhe aftësitë e kërkuara


	Shkolla dhe komuna	Sektorët të industrive që janë në rritje/zhvillim në komunë	Kompanitë e mundshme punëdhënëse për nxënësit	Lista e aftësive/shkathtësive që kërkohen më tepër nga tregu i punës
1.	ShFMU “Nazim Gafurri”, Prishtinë	Sektori i TI-së, ndërtimtaria, call center;	Sektori i TI-së, ndërtimtarisë, call center, etj.	Aftësi digjitale, njohja e gjuhëve të huaja, etj.
2.	ShFMU “Ibrahim Fehmiu”, Prizren	Tregtia, prodhimi	“ABI” dhe “Liri”	Mësimi dual (profesional/zanatet)
3.	ShFMU “Pjetër Bogdani”, Prishtinë	Teknologjia informative, inxhinieria elektrike;	Kompanitë e teknologjisë informative;	Mjekësia, inxhinieria kompjuterike dhe softverike, infermieria, gjuha gjermane;
4.	ShFMU “Thimi Mitko”, Gjilan	Prodhimi, gastronomia, TI	Restorant “Bujana”, Hotel Astoria;	Shërbimi, aftësitë digjitale;

5.	ShFMU “Liria”, Vushtri	Përpunimi i drurit, metalit, prodhimi i produkteve të patateve	“BINNI”, “Vipa çips”, “Ciao Berto”, “Ariani Compani”, “Butrinti”.	Sektori i prodhimit të drurit, dritareve, sektori i ndërtimit, hotelieri, etj.
6.	ShFMU “Rexhep Kadrija”, Deçan	Turizmi, ekonomia dhe zhvillimi rural	“Gogaj AG”, “VivaFresh”, ETC;	aftësi për shitje, teknologji me TIK;
7.	ShFMU “Ramë Billaca”, Therandë	Sektori i pijeve, sektori i tekstitit, sektori i prodhimeve bujqësore, tregtia.	“Solidi”, “Golden Eagle”, “Hidro Term” etj.	Shkathtësitë komunikuese, njohja e gjuhëve të huaja, shkathtësitë kompjuterike, kreativiteti, etj.
8.	ShFMU “Xhemail Mustafa”, Prishtinë	Fabrikat e ujit dhe të lëngjeve dhe mobilieritë e ndryshme	“Ipko”, “Art Motion”, fabrikat e mobilierive	Puna praktike edhe pse moshë e fëmijëve të shkollës është nën 14
9.	ShFMU “Asim Vokshi”, Prishtinë	Tregtia, zejtaria, ndërtimtaria, gastronomia	Vila “Germia”, “VivaFresh Store”, ETC, automekanikë të ndryshëm	Shkathtësitë e punës ekipore, aftësi të komunikimit, menaxhimit, organizimit, etj.
10	ShFMU “Bedri Gjinaj”, Mitrovicë	Sektori i mobilierive dhe gastronomisë, industria e drurit;	“Veli kompani”, “Bunjamini”, “Hotel Palace”, Fabrika e Mobileve	Reklama dhe ueb- dizajn, përpunimi i drurit, tekstitit
11.	ShFMU “Shaban Jashari”, Skenderaj	Kompani ndërtimi dhe prodhimi	“Rukolli”, “Drena”, QTA, “Rreze Commerc”.	Komunikim, bashkëpunim, përgatitje.
12.	ShFMU “Selman Riza”, Gjakovë	Përpunimi i metaleve- armaturës; Prodhimi i tullave, prodhime zejtare dhe tregtare.	“Comodita”, “Ronifer”, IMN, ETC, VivaFresh.	Shkathtësitë e buta
13.	ShFMU “Zija Shemsiu”, Gjilan	Mekanik, teknologji ushqimore, TIK	Fabrika e qumështit mobilieritë, kuzhinat, zdrukthëtaritë, etj.	Aftësitë digjitale, aftësitë në zdrukthëtaritë dhe mobiliari.
14.	SHFMU “Anton Zako Çajupi”, Mitrovicë	Miniera “Trepça”	Kompanitë ndërtimore, marketet e mëdha, miniera “Trepça”, gastronomia	Përdorimi i teknologjisë, punës fizike

15.	ShFMU “Emin Duraku”, Prishtinë	Ndërtimi/ teknologjia	“Teleperformance”, VALA	Aftësi në TIK
16.	ShFMU “Neze Bujani”, Lipjan	Industri ushqimore	“MAGIC”, “PREMIUM”,	
17.	ShFMU “Emin Duraku”, Shtime	Market “Elira”, SHPK “LONI”, “GAJRE”, mobile, Lulishtja “AGRO KOP”, etj.	Lulishtja “AGRO KOP”, market “Elira”, SHPK “LONI”, “GAJREPI Mobile”	Të kenë aftësi për njohje të punës apo profesionit që synojnë
18.	ShFMU “Tefik Çanga” Ferizaj	Nuk kanë informacion	Nuk kanë informacion	Nuk kanë informacion
19.	ShFMU “Ismail Qemali”, Ferizaj	Gastronomia, zdrukthëtaria, pastiçeria (gatime), etj.	“Cadi Group SHPK”, “Ahikos”, “Ëmbëlsira”, etj.	Shkathtësi komunikimi, njohja e kompjuterit, etj.
20.	ShFMU “Naim Frashëri”, Drenas	Industritë e prodhimit të metaleve, të ndërtimtarisë, industria farmaceutike, industrinë e përpunimit plastik, industria e ndërtimit të ashensorëve (Parku i Biznesit, Drenas)	Kompania “NewCo”, “Feronikli”, “BAU Center”, Ndërmarrja ndërtimore BMG”, “AKTIV”, etj.	Njohuri akademike, aftësi të buta, që lidhen me komunikimin, zgjidhjen e problemeve, punën më grupe, etj.

Nevoja për mbështetje nga projekti për funksionimin e Klubeve të karrierës

Të gjitha 20 shkollat pjesëmarrëse në anketim janë shprehur se kanë nevojë të mbështeten, qoftë në themelimin apo edhe fuqizimin e Klubeve të karrierës nëpërmjet trajnimeve, materialeve informuese dhe udhëzuese si doracak, udhëzues, broshura, etj., si dhe nëpërmjet mentorimit (shih grafikun 5.)



Grafiku 5. Nevoja për mbështetjen e Klubeve të karrierës nga projekti

Duke qenë se shumica e tyre shprehen se sfida më e madhe mbetet mungesa e buxhetit për funksionimit efektiv të Klubit, disa prej tyre shprehin nevojën për financim, gjë që projekti nuk parasheh. Përmes doracakëve dhe trajnimeve që do të zhvillohen për menaxhmentin e shkollës dhe atyre për funksionimin e Klubeve, do të ofrohen rekomandime për mënyrat e ngritjes së fondeve dhe mbështetjes financiare për funksionimin e Klubeve. Ndër të tjera, nga shkollat partnere shprehet edhe nevoja për përkrahje me mjete materiale, sigurim të vizitave në kompani, furnizim me kompjuterë, kamera, printerë, projektorë, pajisje zërimi, me instalim të një radioje shkollore ku nxënësit do të përdornin teknologjinë për aktivitete të ndryshme. Po ashtu, theksohet nevoja për organizimin e panairëve, ofrimin e punës vullnetare, sigurimin e instrumenteve muzikore, mjeteve për art si kavaleta, vizatime, ngjyra për organizime të ekspozitave të ndryshme, e të tjera.

Përfundime dhe rekomandime

Klubet e karrierës në shkollat partnere kanë një histori të ndryshme të funksionimit , po edhe nivel të ndryshëm të përfshirjes së nxënësve dhe komunitetit të biznesit. Bazuar në të dhënat, duket se edukimi dhe orientimi në karrierë ofrohet në shumicën e shkollave në kuadër të fushës "Jeta dhe puna". Në disa raste, kjo temë është integruar në lëndët e tjera, ndërsa në disa shkolla ofrohet nga psikologu i shkollës, këshilltari/ja për karrierë ose si lëndë zgjedhore. Ky model për të ofruar edukim dhe orientim në karrierë në forma të ndryshme tregon një përkushtim ndaj sigurimit të një përvoje të pasur për nxënësit në këtë fushë, por në anën tjetër edhe nevojën për unifikimin e ofrimit të shërbimeve të karrierës për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta. Në të gjitha shkollat, interesi i nxënësve për të marrë pjesë në aktivitetet e Klubit të karrierës vlerësohet si pozitiv ose mesatarisht pozitiv. Ky është një aspekt që tregon potencialin e klubeve për të shërbyer si burim i rëndësishëm për zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Bashkëpunimi me kompanitë e biznesit është në nivele të ndryshme, dhe ka raste kur ky bashkëpunim ka munguar, ndërsa në disa raste është vlerësuar si i kënaqshëm. Në disa raste, veçanërisht në shkolla si "Nazim Gafurri" në Prishtinë dhe "Pjetër Bogdani" në Prishtinë, niveli i bashkëpunimit me komunitetin e biznesit është vlerësuar si jo i kënaqshëm. Kjo mund të jetë një sfidë për të siguruar mundësi më të mira për praktikantët në punë dhe krijimin e lidhjeve me botën e biznesit. Disa shkolla përballen me sfida financiare në funksionimin e Klubit të karrierës. Ndërsa disa prej tyre kanë një buxhet të ndarë për aktivitetet e klubit, të tjerët mbështeten kryesisht në donacione dhe angazhimin vullnetar të stafit. Kjo mund të jetë një pengesë për zbatimin e plotë të aktiviteteve dhe për zgjerimin e pjesëmarrjes së nxënësve. Të gjitha 20 shkollat pjesëmarrëse në anketim kanë shprehur nevojën e tyre për mbështetje në themelimin ose fuqizimin e Klubeve të karrierës. Nevojat e tyre përfshijnë trajnime, materiale informuese dhe udhëzuese, mentorim, si dhe financim për funksionimin e Klubit. Sfidat kryesore për këto shkolla është mungesa e buxhetit për funksionimin efektiv të Klubit të karrierës. Përveç financimit, shkollat gjithashtu shprehin nevojën për përkrahje me mjete materiale, organizim të vizitave në kompani, pajisje

teknologjike si kompjuterë, kamera, printerë, etj., si dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme si panaire, punë vullnetare, etj.

Klubet e karrierës duhet të përqëndrohet në sigurimin e resurseve të nevojshme, përfshirë hapësirën e dedikuar, buxhetin dhe stafin e specializuar. Është e rëndësishme të përmirësohet bashkëpunimi me komunitetin e biznesit për të siguruar mundësi të reja për nxënësit dhe për të siguruar ofrimin e praktikave apo trajnimeve. Po ashtu, promovimi i aktiviteteve të Klubit duhet të intensifikohet duke përdorur mjete të ndryshme të komunikimit dhe duke organizuar aktivitete të veçanta për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.

Shkollat duhet të hartojnë plane afatgjata për financimin e Klubit të karrierës, duke përfshirë aplikime për fonde nga burime të ndryshme dhe duke krijuar partneritete të qëndrueshme me bizneset lokale. Kësisoj, menaxhmenti i shkollës duhet të krijojë standarde më të larta për funksionimin e Klubit të karrierës, duke përdorur shembujt e suksesit dhe duke zbatuar praktikatat më të mira nga shkollat tjera. Me implementimin e këtyre rekomandimeve, pritet që Klubet e karrierës në këto shkolla të jenë më të suksesshme dhe të ofrojnë një ndikim pozitiv më të madh në orientimin dhe zhvillimin e karrierës së nxënësve.

Shtojca

PYETËSOR

ANALIZA E NEVOJAVE TË SHKOLLAVE PARTNERE PËR
THEMELIMIN OSE FUQIZIZIMIN E KLUBEVE TË
KARRIERËS

Prishtinë, 2024

Pyetësor për hulumtimin e nevojave të shkollave partnere (GIZ) për themelimin/fuqizimin e Klubeve të karrierës

Të nderuar udhëheqës të shkollave partnere,

Në kuadër të projektit “Mbështetja e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta përmes zhvillimit dhe forcimit të Klubeve të Karrierës” i financuar nga GIZ-i dhe implementuar nga MDA-ja, synohet mbështetja e shkollave për themelimin ose fuqizimin e Klubeve ekzistuese të karrierës në 20 shkolla të mesme të ulëta në 13 komuna.

Qëllimi i këtij pyetësori është të mblidhen informatat rreth nevojës dhe potencialit për themelimin ose fuqizimin e klubit të karrierës në shkollën tuaj, që mund të jenë vendimtare për hartimin e një plani të veprimit në realizimin e qëllimit të projektit. Kësisoj, ju lutemi që të ndani 10 minuta kohë që të plotësoni seksionin që përshtatet me nevojat tuaja.

Pyetësori përmban 4 seksione:

Seksioni 1: Të dhënat demografike

Seksioni 2: Nevojat e shkollës që tashmë e ka të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional

Seksioni 3: Nevojat e shkollës që tashmë ka të themeluar Klubin e karrierës por nuk është funksional

Seksioni 4: Nevojat e shkollës që shpreh interesim për themelimin e Klubit të karrierës

Pas mbledhjes së informatave nëpërmjet këtij pyetësori, do të përgatitet një raport përmbledhës i nevojave të shkollave respodente drejt themelimit/fuqizimit të Klubeve të karrierës.

Ju falënderojmë paraprakisht për plotësimin e pyetësorit!

* Indicates required question

Email*

SEKSIONI 1: TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

1. Emri i shkollës*

2. Komuna*

Gjilan

Prizren

Gjakovë

Shtime

Therandë

Deçan

Lipjan

Mitrovicë

Vushtrri

Ferizaj

Drenas

Skenderaj

Prishtinë

Other:

3. Numri i nxënësve prej klasës VI deri IX (shëno numrin)*

4. Pozita juaj e punës në shkollë*

Drejtor/eshë e shkollës

Koordinator i cilësisë

Zv. drejtor/zv.drejtoreshë

Sekretar i shkollës

Këshilltar/e për karrierë

Other:

5. Numri kontaktues

6. Në çfarë forme ofrohet për nxënësit e shkollës tuaj edukimi/orientimi në karrierë (mund të zgjedhni disa opsione)*

Si koncept në kuadër të fushës "Jeta dhe puna"

Tema të integruara në lëndë të tjera

Nëpërmjet këshilltarit për karrierë

Nëpërmjet psikologut të shkollës

Momentalisht nuk zbatohet nga askush

Other:

7. A ka shkolla juaj këshilltar për karrierë?

Po

Jo

Other:

8. Zgjedhni opsionin që u përshtatet dhe vazhdoni në seksionin e rekomanduar*

Shkolla jonë e ka të themeluar Klubin e karrierës dhe është funksional (vijon në seksionin 2)

Shkolla jonë e ka të themeluar Klubin e karrierës por nuk është funksional (vijon në seksionin 3)

Shkolla jonë është e interesuar të themelojë Klubin e karrierës (vijon në seksionin 4)

Other:

SEKSIONI 2: SHKOLLA JONË E KA TË THEMELUAR KLUBIN E KARRIERËS DHE ËSHTË FUNKSIONAL

9. Në cilin vit është themeluar Klubi i karrierës në shkollën tuaj?*

10. Prej kujt udhëhiqet Klubi i karrierës në shkollën tuaj?*

Prej mësimdhënësit të fushës "Jeta dhe puna"

Prej nxënësve

Prej këshilltarit për karrierë

Prej menaxhmentit të shkollës

Prej psikologut/es së shkollës

Other:

11. Sa anëtarë i ka Klubi i karrierës?*

12. A e ka Klubi i karrierës hapësirën e vet për takime dhe aktivitete?*

Po

Jo

Other:

13. A e ka Klubi i karrierës në shkollën tuaj planin vjetor të punës?*

Po

Jo

Other:

14. Cilat janë aktivitetet kryesore të Klubit të karrierës në shkollën tuaj (mund të zgjedhni disa opsione)*

Ligjerata informuese

Takime me punëdhënësit/Të ftuar si folës

Diskutime/ Debate për tema të orientimit në karrierë

Vlerësimi i interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, etj

Punëtori të ndryshme

Takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë

Panairë të karrierës

Këshillim në karrierë

Other:

15. Sa jeni të kënaqur më interesimin e nxënësve për t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës?*

Shumë të kënaqur

Të kënaqur

Mesatarisht të kënaqur

Të pakënaqur

Aspak të kënaqur

16. Shënoni cilat strategji përdor menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit për zhvillimin apo rritjen e popullaritetit të klubit? (mund të zgjedhni disa opsione apo/dhe të shënoni të tjera)*

Promovimi i aktiviteteve nëpërmjet broshurave/posterëve

Prezantimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve të tjera

Vizita në kompani lokale

Artikuj të shkruar pas ngjarjeve të organizuara

Rrëfime suksesi

Fushata vetëdijësuese

Promovimi në rrjete sociale

Other:

17. Cilat rrjete sociale ose media të tjera të informimit dhe të komunikimit i përdorni për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës? (mund të zgjedhni disa opsione)*

TV

Radio

Buletinët e shkollës

Ueb-faqen e shkollës

Facebook

Instagram

LinkedIn

Twitter

Revistën e shkollës

Asnjë nga të lartcekurat

Other:

18. Prej 1 deri 5, me cilën shkallë e vlerësoni nivelin e marrëdhënies së shkollës tuaj me komunitetin e biznesit në komunën tuaj?*

E pakënaqshme

1

2

3

4

5

E shkëlqyer

19. Prej 1 deri 5, vlerësoni sa është i interesuar komuniteti i biznesit për bashkëpunim me shkollën tuaj?*

Aspak i interesuar

1

2

3

4

5

Shumë i interesuar

20. Sa është numri i kompanive/ organizatave me të cilat bashkëpunon Klubi i karrierës (shënoni numrin)?*

21. Shënoni ndonjë/disa shembuj se si janë të përfshira kompanitë në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

22. Shënoni disa sektorë të industrive që janë në rritje/zhvillim në komunën tuaj?*

23. Shënoni disa nga kompanitë më të mëdha në komunën tuaj që sipas jush kanë më shumë mundësi të punësojnë nxënësit tuaj në të ardhmen?*

24. Shënoni cilat janë aftësitë/ shkathtësitë që kërkohen më tepër nga tregu i punës në komunën tuaj?*

25. A ka Klubi i karrierës buxhet të parashikuar për aktivitetet e planifikuara (p.sh. për vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, etj.)*

Po

Jo

26. Nëse po, sa është buxheti i parashikuar për aktivitetet vjetore të Klubit? (shëno shumën)*

27. Nëse jo, shpjegoni se si i mbulonit shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të Klubit apo se si planifikoni ta bëni në të ardhmen*

28. A ekziston ndonjë sfidë që hasni në funksionimin e Klubit të karrierës?

*

Po

Jo

Other:

29. Nëse po, cila është sfida që keni në funksionimin e Klubit të karrierës? (mund të zgjedhni disa opsione)*

Financat

Marketing (promovimi i aktiviteteve)

Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit

Bashkëpunim me Klubet tjera të karrierës

Aftësitë e nxënësve për menaxhimin e Klubit

Mungesë e informatave për tregun e punës

Other:

30. Prej 1 deri 5, sa mund të siguroni përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

31. Prej 1 deri 5, sa mund të siguroni përkrahjen/përfshirjen e prindërve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

32. Prej 1 deri 5, sa mund të siguroni përkrahjen/përfshirjen e komunitetit/profesionistëve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

33. Sipas jush, si do mund të mbështetet/përkrahet Klubi i karrierës në shkollën tuaj nga projekti në fjalë?*

Nëpërmjet trajnimeve

Nëpërmjet materialeve informuese dhe udhëzuese (doracak, udhëzues, broshura, etj)

Nëpërmjet mentorimit

Other:

34. A keni diçka të shtoni që është interes të dihet nga projekti me qëllim fuqizimin e Klubit të karrierës në shkollën tuaj?

Faleminderit që plotësuat pyetësin!

Klikoni "*dërgo pyetësin*" për të përmbyllur plotësimin e tij. *

Dërgo pyetësin

SEKSIONI 3: SHKOLLA JONË E KA TË THEMELUAR KLUBIN E KARRIERËS POR NUK ËSHTË FUNKSIONAL

35. Në cilin muaj dhe vit është themeluar Klubi i karrierës në shkollën tuaj?*

36. Prej cilit muaj dhe vit nuk është më funksional?*

37. Prej kujt është udhëhequr Klubi i karrierës në shkollën tuaj?*

Prej mësimdhënësit të fushës "Jeta dhe puna"

Prej nxënësve

Prej këshilltarit për karrierë

Prej menaxhmentit të shkollës

Prej psikologut/es

Prej askujt

Other:

38. Cila është arsyeja (arsyet) e mosfunksionimit të Klubit të karrierës? (mund të zgjedhni disa opsione)*

Mungesa e udhëheqësit

Mungesa e hapësirës së dedikuar

Mungesa e trajnimit të udhëheqësit/sve për realizimin e aktiviteteve

Mungesa e buxhetit

Mungesa e koordinimit

Mungesa e aftësive për menaxhim

Mungesa e interesimit për bashkëpunim nga ana e kompanive/profesionistëve

Other:

39. Prej 1 deri 5, sa jeni të interesuar ta rifunksionalizoni Klubin e karrierës?*

Të painteresuar

1

2

3

4

5

Shumë të interesuar

40. Për aq kohë sa ka funksionuar Klubi i karrierës, cilat ishin aktivitetet kryesore të Klubit të karrierës në shkollën tuaj (mund të zgjedhni disa opsione)*

Ligjerata informuese

Takime me punëdhënësit/Të ftuar si folës

Diskutime/ Debate mbi tema të orientimit në karrierë

Vlerësimi i interesave, talenteve, vlerave të nxënësve, etj.

Punëtori të ndryshme

Takime me prindërit rreth temave të edukimit dhe orientimit në karrierë

Panaire të karrierës

Këshillim në karrierë

Other:

41. Sa jeni të kënaqur më interesimin e nxënësve pët t'u bërë pjesë e aktiviteteve të Klubit të karrierës?*

Shumë të kënaqur

Të kënaqur

Mesatarisht të kënaqur

Të pakënaqur

Aspak të kënaqur

42. Prej 1 deri 5, me cilën shkallë e vlerësoni nivelin e marrëdhënies së shkollës tuaj me komunitetin e biznesit në komunën tuaj?*

E pakënaqshme

1

2

3

4

5

E shkëlqyer

43. Prej 1 deri 5, vlerësoni sa është i interesuar komuniteti i biznesit për bashkëpunim me shkollën tuaj?*

Aspak i interesuar

1

2

3

4

5

Shumë i interesuar

44. Shënoni cilat strategji ka përdor menaxhmenti i shkollës dhe/ose sekretariati i Klubit për zhvillimin apo rritjen e popullaritetit të klubit? (mund të zgjedhni disa opsione apo/dhe të shënoni të tjera)*

Promovimi i aktiviteteve nëpërmjet broshurave/posterëve

Prezantimi i aktiviteteve gjatë orëve mësimore apo ngjarjeve tjera

Vizita në kompani lokale

Artikuj të shkruar pas ngjarjeve të organizuara

Rrëfime suksesi

Fushata vetëdijësuese

Other:

45. Cilat rrjete sociale ose media të tjera të informimit dhe të komunikimit i përdorni ose planifikoni t'i përdorni për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës? (mund të zgjedhni disa opsione)

*

TV

Radio

Buletinët e shkollës

Ueb-faqen e shkollës

Facebook

Instagram

LinkedIn

Twitter

Revistën e shkollës

Other:

46. Sa është numri i përafërt i kompanive/ organizatave me të cilat ka bashkëpunuar Klubi i karrierës? *

47. Shënoni ndonjë shembull se si ishin të përfshira kompanitë/organizatat/profesionistët në aktivitetet e Klubit të karrierës? *

48. Shënoni disa sektorë të industrive që janë në rritje/zhvillim në komunën tuaj? *

49. Shënoni disa nga kompanitë më të mëdha në komunën tuaj që sipas jush kanë më shumë mundësi të punësojnë nxënësit tuaj në të ardhmen? *

50. Shënoni cilat janë aftësitë/ shkathtësitë që kërkohen më tepër nga tregu i punës në komunën tuaj?

51. A ka apo a ka pasur Klubi i karrierës buxhet të parashikuar për aktivitetet e planifikuara (p.sh. për vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, etj. ?)*

Po

Jo

52. Nëse po, sa është apo sa ishte buxheti i parashikuar për aktivitetet vjetore të Klubit? (shëno shumën) *

53. Nëse jo, shpjegoni si i mbulonit shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të Klubit apo si planifikoni ta bëni në të ardhmen?*

54. Prej 1 deri 5, sa mund të siguron përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

55. Prej 1 deri 5, sa mund të siguron përkrahjen/përfshirjen e prindërve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

56. Prej 1 deri 5, sa mund të siguroni përkrahjen/përfshirjen e komunitetit/profesionistëve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

57. Sipas jush, si do mund të mbështetet/përkrahet Klubi i karrierës në shkollën tuaj nga projekti në fjalë?*

Nëpërmjet trajnimeve

Nëpërmjet materialeve informuese dhe udhëzuese (doracak, udhëzues, broshura, etj)

Nëpërmjet mentorimit

Other:

58. A keni diçka të shtoni që është interes të dihet nga projekti me qëllim fuqizimin e Klubit të karrierës në shkollën tuaj?

Faleminderit që plotësuat pyetësin!

Klikoni "*dërgo pyetësin*" për të përmbyllur plotësimin e tij.

*

Dërgo pyetësin

SEKSIONI 4: SHKOLLA JONË ËSHTË E INTERESUAR TË THEMELOJË KLUBIN E KARRIERËS

59. keni hasur në ndonjë sfidë apo shqetësim specifik që ju ka penguar ta themeloni Klubin e karrierës?*

Po

Jo

60. Nëse po, ju lutemi shënoni arsyet që ju kanë penguar në themelimin e Klubit të karrierës?*

61. A keni hapësirë për takimet dhe aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Po

Jo

Other:

62. A planifikoni të ndani buxhet për aktivitetet e Klubit të karrierës (p.sh. vizita në kompani, trajnime, materiale informuese dhe promovuese, logjistikë, etj.)?*

Po

Jo

Other:

63. Nëse po, sa është buxheti që planifikoni ta ndani për aktivitetet e Klubit të karrierës? (shëno shumën)*

65. Nëse jo, shpjegoni si planifikoni t'i mbulonit shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të Klubit?*

66. Prej 1 deri 5, me cilën shkallë e vlerësoni nivelin e marrëdhënies së shkollës tuaj me komunitetin e biznesit në komunën tuaj?

*

E pakënaqshme

1

2

3

4

5

E shkëlqyer

67. Prej 1 deri 5, vlerësoni sa është i interesuar komuniteti i biznesit për bashkëpunim me shkollën tuaj?*

Aspak i interesuar

1

2

3

4

5

Shumë i interesuar

68. Sa është numri i kompanive/ organizatave me të cilat mund të inicioni bashkëpunim pas themelimit të Klubit i klubit (shënoni numrin)?*

69. Shënoni një ose disa shembuj se si planifikoni të përfshini kompanitë në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

70. Shënoni disa sektorë të industrive që janë në rritje/zhvillim në komunën tuaj?*

71. Shënoni disa nga kompanitë më të mëdha në komunën tuaj që sipas jush kanë më shumë mundësi të punësojnë nxënësit tuaj në të ardhmen?*

72. Shënoni cilat janë aftësitë/ shkathtësitë që kërkohen më tepër nga tregu i punës në komunën tuaj?*

73. Cilat rrjete sociale ose media të tjera të informimit dhe të komunikimit planifikoni t'i përdorni për promovimin e aktiviteteve të Klubit të karrierës? (mund të zgjedhni disa opsione)

*

TV

Radio

Buletinët e shkollës

Ueb-faqen e shkollës

Facebook

Instagram

LinkedIn

Twitter

Revista e shkollës

Other:

74. Sipas jush, cilat mund të jenë sfidat që mund të keni në funksionimin e Klubit të karrierës? (mund të zgjedhni disa opsione)*

Financat

Marketing (promovimi i aktiviteteve)

Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit

Bashkëpunim me Klubet tjera të karrierës

Aftësitë e nxënësve për menaxhimin e Klubit

Mungesë e informatave për tregun e punës

Other:

75. Prej 1 deri 5, sa mund të siguron përkrahjen/përfshirjen e nxënësve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

76. Prej 1 deri 5, sa mund të siguron përkrahjen/përfshirjen e prindërve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

77. Prej 1 deri 5, sa mund të siguroni përkrahjen/përfshirjen e komunitetit/profesionistëve në aktivitetet e Klubit të karrierës?*

Pak

1

2

3

4

5

Shumë

78. Sipas jush, si do mund të mbështetet/përkrahet Klubi i karrierës në shkollën tuaj nga projekti në fjalë?*

Nëpërmjet trajnimeve

Nëpërmjet materialeve informuese dhe udhëzuese (doracak, udhëzues, broshura, etj)

Nëpërmjet mentorimit

Other:

79. A keni diçka të shtoni që është interes të dihet nga projekti me qëllim themelimin/fuqizimin e Klubit të karrierës në shkollën tuaj?

Faleminderit që plotësuat pyetësin!

Klikoni "*dërgo pyetësin*" për të përmbyllur plotësimin e tij.

*

Dërgo pyetësin

